



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 22 Prot.

Tiranë, më datë 19.04.2023

VENDIM
Nr. 219, datë 19.04.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 19.04.2023:

VENDOSI:

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Rikonstruksion objekti dëmtuar nga tërmeti”, brenda kufirit Zonë Arkeologjike "A", me aplikues Studio Services DC dhe zhvillues Mynyr Llaftiu;

Projekti të plotësohet me:

- Rilevim me kuota të gjendjes aktuale të objektit;
- Paraqitjen teknike në prerje të themeleve ekzistuese si dhe atyre të propozuara;
- Raporti i potencialit arkeologjik duhet të hartohet në përputhje me VKM Nr. 220, datë 7.4.2021 për “Hulumtimet Arkeologjike” dhe “Rregulloren mbi Kriteret e Ushtrimit të Profesionit të Arkeologut”, miratuar me Vendim Nr.2 datë 30.01.2009.

2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ndaj vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

